VENDIM
Nr. 930, datë 28.12.2016

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË AGJENCISË SË AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË ASISTENCËS, AKREDITUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 21, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" dhe të pikës 4, të nenit 6, të ligjit nr.90/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga BE-ja, të jetë sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Organika e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga BE-ja, të jetë sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Numri i punonjësve të Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga BE-ja, të jetë, gjithsej, 16 veta.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SKEMA 1

STRUKTURA E AGJENCISË SË AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË ASISTENCËS, AKREDITUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË
(PROJEKT)



SKEMA 2

ORGANIKA E AGJENCISË SË AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË ASISTENCËS, AKREDITUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

POZICIONI	KATEGORIA E PAGËS	NUMRI
I.DREJTOR I PËRGJITHSHËM (TITULLAR INSTITUCIONI)	**II - a**	**1**
II. ZËVENDËS DREJTOR I PËRGJITHSHËM	**II - b**	**1**
III. DREJTORIA AUDITIMIT		**(6)**
AUDITUES TË PARË	**II- b**	**2**
AUDITUES TË DYTË	**III-a**	**4**
IV. **DREJTORIA METODOLOGJISE DHE SIGURIMIT TE CILESISE**		**(5)**
DREJTOR DREJTORIE	**II-b**	**1**
AUDITUES TË PARË	**II- b**	**2**
AUDITUES TË DYTË	**III-a**	**2**
V. SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE		**(3)**
PËRGJEGJËS SEKTORI	**III/1-a**	1
SPECIALIST FINANCE	**IV-a**	1
SPECIALIST I SHËRBIMEVE	**IV-a**	1
PUNONJËS GJITHSEJ		**16**